

MARRËVESHJE
PËR
SHITJEN DHE TRANSFERIMIN E KUOTAVE

Ndërmjet

Z. Andi Zhugli

dhe

Z. Alfred Bundo

Data 22 Prill 2020

Kjo MARRËVESHJE PËR SHITJEN DHE TRANSFERIMIN E KUOTAVE (në vijim "Marrëveshja") nënshkruhet sot më datë 22 Prill 2020 ("Data e Marrëveshjes"), nga dhe ndërmjet Z.Andi Zhugli , shtetas shqiptar, identifikuar nepermjet dokumentit te identifikimit (ID) me nr: H10724036L, i datëlindjes 24.07.1971, lindur dhe banues ne Tiranë (në vijim "Shitësi"), ku shitësi është ortak i vetëm i Shoqërisë (sic është përkufizuar më poshtë), si dhe Z.Alfred Bundo , shtetas shqiptar, identifikuar nepermjet dokumentit te identifikimit (ID) me nr:H10514193D, lindur me datë 14.05.1971, ne Fier, (në vijim referuar si "Blerësi").

Shitësi dhe Blerësi referohen në këtë Marrëveshje si "Pala" dhe së bashku "Palët", sipas varianteve të tyre gjuhësore në njëjës ose në shumës, siç mund t'a kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Marrëveshje. Palët e mësipërme vullnetarisht deklarojnë sa më poshtë:

MEQENËSE, shoqëria "ALBENECON" sh.p.k, është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, me veprimtari Konsulencës dhe projektme inxhinierike në fushën e energjisë, ndërtimit, dhe mekanike , me seli në Tiranë, Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Todi Shkurti, Nr.15, banese private, e themeluar në datë 31.08.2018, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë QKB me numër unik identifikimi NUIS/NIPT: L82031006T (në vijim referuar si "Shoqëria");

MEQENËSE, Shitësi është ortak i vetëm i Shoqërisë, ka në pronësi dhe zotëron 1 (një) Kuotë (siç përkufizohet më poshtë) me vlere nominale 400.000 lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë në Datën e Marrëveshjes, Kuotë të cilën dëshiron ta pjestojë, duke ja shitur dhe transferuar këtë pjesë Blerësit;

MEQENËSE, Blerësi ka rënë dakord që të blejë nga Shitësi 1 Kuotë të Shoqërisë që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar me vlerë nominale 400.000 dhe Shitësi ka rënë dakord me Blerësin për të shitur Kuotën në fjalë, sipas termave dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje në bazë të së cilës, Blerësi do të përfitojë Kuotën që do t'i kalojë në pronësi të tij me lidhjen e Marrëveshjes dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara nga Palët sipas kësaj Marrëveshjeje.

BAZUAR NË SA MË SIPËR, dhe duke marrë në konsideratë të drejtat, detyrimet, garancitë dhe premtimet reciproke që përmbahen në këtë Marrëveshje, si dhe bazuar në Legjislacionin e Zbatueshëm (siç përkufizohet më poshtë), përfshirë, pa kufizim, nenet 117 e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI I . PARASHTRIMET, PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

Paragrafi 1.01 Parashtrimet

Te gjitha parashtrimet e mësipërme në preambul janë pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj Marrëveshje.

Paragrafi 1.02 Përkufizimet

FJALËT E PËRDORURA NË KETË MARRËVESHJE ME GERMA KAPITALE DO TË KENË KUPTIMIN SI MË POSHTË:

"**Kuota**" do të thotë 1 Kuotë të Shoqërisë të mbajtur nga Shitësi që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.



“**Autorizim**” do të kuptohen autorizimet, lejet, licencat, miratimet dhe deklaratimet dhe moskundërshtimet e deklaratimeve, të kërkuara nga Blerësi për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

“**Banka e Shqipërisë**” nënkupton bankën qendrore të Republikës së Shqipërisë.

“**Barrë**” do të kuptohet çdo interes ose kapital i çdo Personi (duke përfshirë çdo të drejtë për të blerë, opsioni riblerjeje ose të drejtë parablerjeje) apo çdo barrë hipotekore, kufizim, peng, privilegj, barrë siguruese (përfshirë ato të krijuara me ligj), posedim titulli ose marrëveshje të tjera siguruese apo marrëveshje të tjera, qira, blerje me këste, shitje me kredi ose marrëveshje të tjera për shlyerjen me këste.

“**Blerësi**” është Z. Alfred Bundo, siç është detajuar në preambul.

“**Çmimi i Shitjes**” është çmimi i përcaktuar në nenin III të kësaj Marrëveshjeje.

“**Data e Firmosjes së Marrëveshjes**” nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

“**Data e Pagesës**” do të kuptohet data në të cilën Blerësi kryen pagesën siç është përcaktuar në nenin III të kësaj Marrëveshjeje.

“**Dite Pune**” do të kuptohet çdo ditë kalendarike e ndryshme nga e shtuna dhe e diela dhe çdo ditë tjetër në të cilën bankat nuk janë të hapura për kryerjen e aktivitetit të zakonshëm në Tiranë.

“**Entitet Qeveritar**” do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, çdo ministri, departament, ose nënndarje e tyre; dhe (ii) çdo Person tjetër, agjensi apo autoritet nën kontrollin e drejtpërdrejt ose jo të Republikës së Shqipërisë, çdo ministrie, departamenti, apo nënndarje e tyre politike, që ka juridiksion mbi Palët sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

“**Informacion Konfidencial**” ka kuptimin e parashikuar në nenin VIII.

“**Kalimi i Pronësisë**” ka kuptimin e parashikuar në Paragrafin 2.02 të kësaj Marrëveshjeje.

“**Garanci**” do të kuptohen deklaratimet dhe garancitë e dhëna nga Shitësi Blerësit dhe nga Blerësi Shitësit në nenin V të kësaj Marrëveshjeje.

“**Legjislacioni i Zbatueshëm**” përfshin, pa kufizim, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, Ligjin nr.131/2015, dt. 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, si dhe çdo akt i Entiteteve Qeveritare, përfshirë, ligj, akt nënligjor, urdhëresë, dekret, rregullore, udhëzim, licence, autorizim ose aprovim tjetër nga një Entitet Qeveritar që ka juridiksionin dhe autoritetin e duhur mbi Palët, siç mund të ndryshohen herë pas here.

“**Shoqëria**” do të ketë kuptimin e dhënë në preambul.

“**Marrëveshje**” ka kuptimin e dhënë në preambul.



A handwritten signature in black ink, appearing to be "Alfred Bundo".

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Alfred Bundo".

“Mbyllje” do të kuptohet mbyllja e shitjes dhe blerjes së Kuotave sipas kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet përmbushjes së detyrimeve përkatëse të Palëve.

“Mosmarrëveshje” ka kuptimin që i është dhënë në Paragrafin 9.01.

“Pala” ose “Palët” ka kuptimin e parashikuar në preambul.

“Person” do të kuptohet çdo individ, person fizik, kompani, ortakëri e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm ose ai i një vendi specifik, përfshirë Entitetet Qeveritare.

“Person i Autorizuar” ka kuptimin e parashikuar në paragrafin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje

“Opsioni i Blerjes” ka kuptimin e parashikuar në paragrafin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

“Shitësi” është z.Andi Zhugli, siç është detajuar dhe në preambul.

“QKB” do të kuptohet Qendra Kombëtare e Biznesit si organi administrativ i themeluar sipas Ligjit nr. 131/2015, dt: 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

“Vendim Gjykatë” ka kuptimin e parashikuar në paragrafin 5.01 (c) të kësaj Marrëveshjeje.


Paragrafi 1.03 Interpretimi

(A) ÇDO E DREJTË, DETYRIM, APO KUSHT I PËRSHKRUAR NË KËTË MARRËVESHJE DUHET TË INTERPRETOHET NË KONTEKSTIN E MARRËVESHJES TË MARRË SI E TËRË DHE DUKE MARRË NË KONSIDERATË QËLLIMET QË NXITËN PALËT PËR TË HYRË NË KËTË MARRËVESHJE. TITUJT E KRERËVE, NENEVE, PARAGRAFËVE, NEN PARAGRAFËVE QË PËRMBAN KJO MARRËVESHJE SI DHE ATO QË JANË NË TABELËN E LËNDËS JANË VETËM PËR REFERENCE DHE NUK DO TË NDIKOJNË NË ASNJË MËNYRË NË KUPTIMIN APO INTERPRETIMIN E KËSAJ MARRËVESHJEJE. TË GJITHA ANEKSET DHE SHTOJCAT BASHKËNGJITUR APO REFERUAR, JANË INKORPORUAR DHE BËJNË PJESË NË KËTË MARRËVESHJE. NËSE NJË FJALË E PËRDORUR NË NDONJË ANEKS APO SHTOJCË FILLON MË GËRMË KAPITALE POR NUK ËSHTË E PËRKUFIZUAR NË KËTË ANEKS APO SHTOJCË, DO TË KETË KUPTIMIN E PËRKUFIZUAR NË KËTË MARRËVESHJE. KUR NË TEKSTIN E KËSAJ MARRËVESHJEJE KA REFERENCA PËR NJË KRE, NEN, PARAGRAF, NËNPARAGRAF, ANEKS, SHTOJCË, TË TILLA REFERENCA LIDHEN ME KREUN, NENIN, PARAGRAFIN, NËNPARAGRAFIN, ANEKSIN APO SHTOJCËN E KËSAJ MARRËVESHJEJE, PËRVEÇSE KUR PËRCAKTOHET NDRYSHJE.

(B) PËRVEÇSE NË RASTET KUR THUHET SHPREHIMISHT NDRYSHJE, NË KËTË MARRËVESHJE:

- (i) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;
- (ii) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;
- (iii) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkatës; dhe
- (iv) Fjala “përfshin”, do të thotë “përfshin, pa u kufizuar”.

NENI II . OBJEKTI I MARRËVESHJES



A handwritten signature in black ink, appearing to be "Andi Zhugli".

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Andi Zhugli".

Paragrafi 2.01 Shitja dhe blerja e Kuotave.

Sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Shitësi merr përsipër dhe i transferon Blerësit, duke garantuar plotësisht titullin e pronësisë, dhe Blerësi merr përsipër të blejë nga Shitësi të gjitha dhe jo më pak se të gjitha Kuotat e rena dakord për t'u shitur në këtë Marrëveshje, dhe të paguajë çmimin e shitjes në përputhje me parashikimin e nenit III të kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 2.02 Kalimi i Pronësisë së ligjshme mbi Kuotat.

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi Kuotat ("Kalimi i Pronësisë"), të lira nga çdo Barrë, nga Shitësi tek Blerësi, do të kryhet në Datën e Firmosjes së Marrëveshjes. Pas firmosjes të kësaj Marrëveshjeje, Blerësi bëhet pronar i një pjese të Kuotave të zotëruara dhe të mbajtura nga Shitësi në Shoqëri, si më poshtë:

Z.Alfred Bundo, pronar i 1 (një) Kuote, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 400.000 Lekë.

Paragrafi 2.03 Formalitetet e Regjistrimit.

Shitësi në këtë mënyrë autorizon regjistrimin e transferimit të Kuotave në Regjistrin Tregtar që mbahet nga QKB, nën emrin dhe pronën e Blerësit, siç përcaktohet në Paragrafin 2.02 të këtij Neni II.

NENI III . ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Paragrafi 3.01 Çmimi i Shitjes

(a) Shitësi bie dakord se do t'i shesë Blerësit Kuotat objekt i kësaj Marrëveshjeje, kundrejt çmimit total të blerjes së Kuotave prej 400.000 Lekë, (në vijim "Çmimi i Shitjes") dhe Blerësi bie dakord se do t'i paguajë Shitësit Çmimin e Shitjes.

(b) Pagimi i Çmimit të Shitjes do të kryhet pa zbritur, kompensuar ose zvogëlime shume të çdo lloji dhe pa zbritur ose mbajtur taksa, tatime ose çdo pagesë tjetër shtetërore ose publike të detyrueshme sipas Legjislacionit të Zbatueshëm e çdo juridiksioni sipas të cilit apo nëpërmjet të cilit kryhet kjo pagesë, përveç kur kjo zbritje tatimi ose tatim në burim kërkohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm.

(c) Çmimi i Shitjes nuk do të përfshijë tarifën e regjistrimit ose të kalimit të pronësisë mbi Kuotat, të cila do të paguhet plotësisht nga Blerësi.

(ç) Përveç sa parashikohet në paragrafët e mësipërm, shuma e Çmimit të Shitjes do të jetë shuma maksimale totale e çmimit që Blerësi do të paguajë për blerjen e Kuotave të Shoqërisë dhe Shitësi garanton se Blerësi nuk do të paguajë shumën tjetër përveç Çmimit të Shitjes.

(d) Blerësi bie dakord se në mënyrë të menjëhershme nga Data e Firmosjes së Marrëveshjes sipas paragrafit 2.02, do të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme për të siguruar që Çmimi i Shitjes do t'i paguhet plotësisht Shitësit në llogarinë bankare të shënuar në paragrafin 3.02 me poshtë.

Paragrafi 3.02 Mënyra e Pagesës

Çmimi i Shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit në Datën e Pagesës do të jetë në monedhën Lekë, duke i dërguar Shitësit provën e SWIFT për transferimin e fondeve menjëherë të përdorshme në llogarinë bankare të mëposhtme (sipas ndryshimeve që mund të kryejë Shitësi në lidhje me këtë informacion):

Llogaria e çelur në: American Bank of Investments, EBAN: AL57210113110000000002067661



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Alfred Bundo".

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Bundo".

Në emër të: Andi Zhugli

Paragrafi 3.03 Pasojat e Kalimit te Pronësisë

Duke filluar nga Data e Firmosjes se Marrëveshjes, Blerësi do të jetë pronar i Kuotave por ai (Blerësi) nuk do të ketë të drejta mbi çdo shpërndarje dividendi, përfitimesh, rezerve ose pasurie që ka të bëjë me Kuotat dhe në përgjithësi, të çdo dhe të gjitha shpërndarjet që do të vendosen, miratohen ose kryhen nga Shoqëria ndaj ortakëve të saj për fitimet, fitimet e akumuluaura, cdo rezervë apo kapital që i takon periudhës deri 31 Dhjetor 2019. Duke filluar nga 22 Prill 2020 e në vijim Blerësi do të ushtrojë në mënyrë të plotë të gjitha të drejtat që burojnë nga Kuotat, përfshire edhe ato ne lidhje me dividendin.

NENI IV . TRANSFERIMET/OPSIONI I BLERJES

Paragrafi 4.01 Kufizimet për Transferimet

(a) Blerësi nuk ka të drejtë që të Transferoje te gjitha apo ndonjë pjese te Kuotave te tij në Shoqëri, tek një palë e tretë, në asnjë nga mënyrat e parashikuara nga ligji (duke përfshirë por pa u kufizuar në: shitje, dhurim, trashëgimi etj.), përveçse sa është shprehur ndryshe ne këtë Marrëveshje dhe përveç rastit kur jepet miratimi me shkrim nga ana e Shitësit.

(b) Çdo Transferim i Kuotave apo interesave te tjerë qe nuk do te kryhet ne përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, do te jete i pavlefshëm dhe nuk do të prodhojë asnjë efekt mbi pronësinë e Kuotave të Shoqërisë.

Paragrafi 4.02 Opsioni i Blerjes

a) Palët bien dakord se në përputhje me këtë Marrëveshje, Shitësi ose çdo person i autorizuar prej tij ("Person i Autorizuar") do të ketë një opsion për te blere ("Opsioni për te Blere") te gjitha (por jo me pak se te gjitha) Kuotat e Blerësit sipas kushteve te përcaktuara në këtë Nen IV të Marrëveshje, e drejte e cila do të jetë e pakufizuar në kohë dhe e transferueshme te trashëgimtarët e Shitësit. Shitësi i cili gëzon Opsionin për te Blere duhet te njoftojë mbi zgjedhjen e tij për te ushtruar Opsionin për te Blere tek Blerësi brenda një afati prej [15 (pesëmbëdhjetë) ditësh].

b) Blerësi pas marrjes së njoftimit nga ana e Shitësit i cili gëzon Opsionin për të Blerë Kuotat sipas paragrafit 4.02 të kësaj Marrëveshje, ka një afat prej 10 (dhjetë) ditësh për të nënshkruar marrëveshjen me Shitësin për të shitur Kuotat e tij në Shoqëri. Nëse brenda këtij afati, Blerësi nuk ndërmer hapat e nevojshëm për të nënshkruar marrëveshjen me Shitësin, Çmimi i Blerjes (në masën që është përcaktuar në paragrafin 4.03 më poshtë), do të depozitohet në emër të Blerësit pranë llogarisë së Noteres Helena Shengjergji (Vako), regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me NUIS: L31912010S me adresë në Tiranë, Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 6, H. 3, Ap. 8, Tiranë, ose çdo pranë çdo noterie tjetër të përcaktuar nga Shitësi, dhe blerja nga Shitësi e kuotave do të konsiderohet e përfunduar.

Paragrafi 4.03 Çmimi i Blerjes

Palët bien dakord se çmimi i blerjes për Kuotat e Blerësit sipas kushteve të paragrafit 4.02 të kësaj Marrëveshje, do te jetë në masën prej 400.000 Lekë.



A handwritten signature in black ink, appearing to be "Andi Zhugli".

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Andi Zhugli".

Paragrafi 4.04 Efekti mbi Kuotat

a) Përqindja e interesit e përfaqësuar nga Kuotat e Blerësit në Shoqëri do të përjashtohen nga çdo llogaritje e përqindjes së interesit total për qellim të ndonjë miratimi të kërkuar nga ortaket sipas kësaj Marrëveshjeje. Pa u kufizuar në përgjithësimin e çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje mbas mbylljes së blerjes së çdo Kuote sipas këtij Neni IV, Blerësi sipas rastit pa pasur nevojë për ndonjë veprim tjetër, nuk do të ketë me asnjë të drejtë në Shoqëri ose kundrejt Shoqërisë, ndonjë ortaku ose ndonjë drejtori, përveç të drejtës për të marrë pagesën për Kuotat e tij në përputhje me këtë Nen IV.

b) Palët bien dakord në mënyrë të pakushtëzuar se, për efekt të regjistrimit të transaksionit në regjistrat e Shoqërisë apo në çdo regjistrat tjetër, përfshirë por pa u kufizuar në regjistrin e QKB, do të mjaftojë deklarata noteriale e lëshuar nga Noteri sipas paragrafit 4.02 (b) më sipër, që vërteton se fondet janë derdhur në llogarinë e saj dhe janë të disponueshme për tërheqje nga Blerësi.

NENI V . DEKLARIMET DHE GARANCITË

Paragrafi 5.01 Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

Në Datën e Marrëveshjes, Blerësi deklaron dhe garanton si më poshtë:

(a) Statusi i Blerësit. Blerësi ka zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar dhe nuk ekziston asnjë fakt në dijeni e tij që ta pengojë atë nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje apo për marrjen përsipër të të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

(b) Kompetencat dhe autoriteti i nevojshëm. Blerësi dhe përfaqësuesi(t) e tij gëzojnë: (i) të drejtën dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Marrëveshjeje dhe për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në të dhe në çdo dokument tjetër për t'u nënshkruar me këtë Marrëveshjeje; (ii) çdo dhe të gjitha Autorizimet të kërkuara sipas Legjislacionit të Zbatueshëm në fuqi për zbatimin e Marrëveshjes janë marrë dhe janë shpërndarë; (iii) Marrëveshja dhe të gjitha dokumentet e tjera për t'u nënshkruar në lidhje me të dhe në të cilat Blerësi është Palë, përbëjnë dhe do të përbëjnë kur të nënshkruhen, detyrime të Blerësit dhe përfaqësuesit apo pasardhësit e tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e tyre.

(c) Asnje Konflikt; Pelqimet. Nënshkrimi i kesaj Marrëveshjeje nga Blerësi dhe zbatimi i transaksioneve të pershkruara ketu, dhe përmbushja e detyrimeve të kesaj Marrëveshjeje, nuk bie në kundërshtim, ose nuk është në shkelje ose në mospërmbushje (me ose pa njoftim ose në shkelje afati, ose të dyja së bashku), ose nuk bën të mundur lindjen e një të drejte për perfundimin, zhdukjen apo pershpejtimin e ndonje detyrimi, ose humbjes së një përfitimi material, apo të rezultojë në krijimin e një Barre mbi ndonje nga asetet ose pronesite të Blerësit, sipas dispozitave të (a) ndonje kontrate, qiraje, license, pakti, marrëveshjeje, zotimi apo çdo lloj tjetër marrëveshjeje ligjore detyruese, në të cilën Blerësi është Palë ose me anë të së ciles ndonje prej pronave apo asetëve të tij është e barresuar (b) ndonje vendimi gjykate, urdher apo dekret ("Vendim Gjykate") ose statut, ligj, urdherese, rregull ose rregullore ose Legjislacioni i Zbatueshem për Blerësin ose mbi pronat dhe asetet e tij. Asnje pelqim, miratim, license, leje, urdher apo autorizim, regjistrim, deklarim ose depozitim në ndonje qeveri apo gjykate që ka juridiksion (qofte kjo shtetërore, federale, krahinore, vendase ose sidoqofte), agjensi administrative ose komision, ose ndonje autoritet shtetëror apo regullator ose agjensi, vendase, e huaj, ose ndershtetërore nuk kerkohet që të merret nga Blerësi në lidhje me nënshkrimin, dergimin dhe zbatimin e kesaj Marrëveshjeje (përveç lejeve apo licensave të nevojshme sipas Legjislacionit të Zbatueshem).



A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name.

A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name.

(d) Statuti i Shoqërisë. Palët bien dakort se menjëherë me firmosjen e kësaj Marrëveshjeje, ato do të ndryshojnë Statutin e Shoqërisë në formën dhe përmbajtjen e paraqitur në Ankesin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 5.02 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

Në Datën e Marrëveshjes, Shitësi deklaron dhe garanton si më poshtë:

(a) Kuotat e parënuara me Barrë. Shitësi, si ortaku i vetëm i Shoqërisë zotëron 1 (një) Kuotë me vlerë nominale 400.000 lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar. Kuotat janë emetuar në mënyrë të vlefshme, plotësisht të shlyera dhe të lira nga çdo Barrë. Nuk ekziston asnjë marrëveshje ose detyrim për të krijuar ose vendosur Barrë në lidhje me Kuotat. Asnjë Person nuk ka pretenduar të ketë të drejtën të vendosë Barrë në lidhje me Kuotat.

(b) Pronari i ligjshëm. Shitësi është pronari i ligjshëm i Kuotave që përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të emetuar të Shoqërisë dhe të drejtave së votës. Shitësi gëzon të drejtën dhe autoritetin e plotë për të shitur, ceduar, kaluar Kuotat në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera të kërkuara nga Legjislacioni i Zbatueshëm shqiptar për t' u kryer nga dhe për llogari të Shitësit, për të autorizuar këtë të fundit për të lidhur dhe zbatuar këtë Marrëveshje, janë kryer në mënyrë të rregullt, kjo Marrëveshje është lidhur dhe nënshkruar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të ligjshëm dhe të vlefshëm të Shitësit të zbatueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

NENI VI . PRETENDIMET PËR DËMSHPËRBLIM

Paragrafi 6.01 Kufizimi i Përgjegjësisë së Shitësit

Shitësi dhe Blerësi bien dakord që Kuotat shiten "siç janë" dhe përveç rasteve të parashikuara në nenin 5.02 me sipër, Shitësi nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj Blerësit për çdo dem që atij mund ti vijë si pasojë e zotërimit të Kuotave që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

NENI VII . HYRJA NË FUQI

Ne baze të kushteve e termave të përmendur këtu, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në Datën e Firmosjes së Marrëveshjes.

NENI VIII . KONFIDENCIALITETI

Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje merr përsipër të mos bëjë të ditur, përhapë ose komunikojë informacione në lidhje me aktivitetin tregtar të Shoqërisë që në atë kohë nuk janë të njohura nga publiku (duke përfshirë detajet e kësaj Marrëveshjeje) dhe nuk janë bërë të njohura si pasojë e shkeljes së parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje ("Informacion Konfidencial"). Gjithashtu, secila Palë merr përsipër të mos përdorë Informacionin Konfidencial për qëllime përfitimi vetjake ose të palëve të treta ose të lejojë apo ndihmojë, nëpërmjet miratimit të heshtur ose mënyra të tjera, palë të treta të përdorin Informacionin Konfidencial në mënyra të ndryshme (i) për aq sa është e nevojshme për ekzekutimin e të drejtave ose për të



A handwritten signature in black ink, appearing to be "B. B. B." or similar.

A handwritten signature in black ink, appearing to be "B. B. B." or similar.

përbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, (ii) nga kërkesat e ligjit, administrative ose rregulloret e bursave që zbatohen ndaj një Pale dhe çdo ortaku të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kësaj Pale. Parashikimet e këtij Neni VIII i shtohen, dhe nuk zëvendësojnë asnjë marrëveshje konfidencialiteti të lidhur më parë ndërmjet Palëve në lidhje me këtë transaksion.

NENI IX . LIGJII ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Paragrafi 9.01 Deklarime mbi Mosmarrëveshjet

Palët bien dakord se çdo Mosmarrëveshje (në vijim "Mosmarrëveshje"), ndërmjet disa ose të gjithë Palëve dhe që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshjeje do të zgjidhen në përputhje me parashikimet e këtij neni.

Paragrafi 9.02 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm shqiptar.

Paragrafi 9.03 Zgjidhjet miqësore

Secila Palë do të përpiqet të zgjidhë në mirëkuptim e mirëbesim dhe me kujdesin e arsyeshëm çdo Mosmarrëveshje ndërmjet disa ose të gjitha Palëve që lindin nga ose kanë lidhje me këtë Marrëveshje.

Paragrafi 9.04 Gjykata kompetente

Në rast se Palët nuk arrijnë t'i zgjidhin Mosmarrëveshjet me mirëkuptim, gjykata kompetente për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Palëve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

NENI X . TË NDRYSHME

Paragrafi 10.01 Njoftimet

a) Te gjitha njoftimet dhe komunikimet e kërkuara apo te lejuara këtu, do te jene me shkrim ne gjuhen Shqipe dhe do te dërgohen me faks ose e-mail dhe menjëherë pas kësaj te konfirmohen me poste te regjistruar dhe me konfirmim marrje te dërguar ne adresat e mëposhtme:

Për Shitësin:

Adresa: Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Todi Shkurti, Nr.15, banese private.

Në vëmendjen e: Z. Andi Zhugli

Tel: +355 68 20 35 919

Email: zhuglia@gmail.com

Për Blerësin:

Adresa: Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Todi Shkurti, Nr.15, banese private.

Në vëmendjen e : Z. Alfred Bundo

Tel: +355 68 20 39 136

Email: albenecon@mail.com.



b) Çdo ndryshim i te dhënave të kontaktit do t'i njoftohen Palës tjetër me ane të postës së regjistruar ose me e-mail për Palën tjetër. Çdo Pale do të mbaje rrezikun e mos-marrjes/mbërritjes së korrespondencës dhe dokumenteve nëse këto nuk janë hartuar në përputhje me formalitetet e këtij Seksioni.

Paragrafi 10.02 Ndashmëria

Kushtet dhe dispozitat e kësaj Marrëveshje janë tërësisht të ndashme dhe vendimi i ndonjë Gjykate që ka juridiksion, e cila shpall të pavlefshme njërën apo disa nga kushtet dhe dispozitat e kësaj Marrëveshje, nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e asnjë prej kushteve dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshje, si dhe kushti apo dispozita e pavlefshme do të zëvendësohen me një formulim të ri dhe të zbatueshëm që reflekton në mënyrë sa më të përafërt qëllimin fillestar të Palëve.

Paragrafi 10.03 Shpenzimet

Secila nga Palët do të përballojë shpenzimet e kryera në lidhje me negocimin, lidhjen e Marrëveshjes dhe mbylljen e dokumentacionit ligjor për shitjen dhe blerjen. Çdo kalim, regjistrim dhe/ose detyrim pulle dhe/ose taksash për t'u paguar si pasojë e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje dhe kalimit të Kuotave do të paguhet nga Blerësi.

Paragrafi 10.04 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje (së bashku me anekset dhe të gjitha dokumentet e referuara në të ose të nënshkruara përpara Mbylljes) përbën Marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson e ka përparësi ndaj të gjitha kontratave, marrëveshjeve ose angazhimeve të mëparshme në lidhje me objektin në fjalë.

Paragrafi 10.05 Ndryshimet

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk kryhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët.

Paragrafi 10.01 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje përben marrëveshjen e plotë dhe kuptimin midis Paleve këtu, lidhur me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme apo të tanishme duke përfshirë, ujdite dhe marrëveshjet qofte me gojë apo me shkrim, ndërmjet Paleve në lidhje me sa më sipër.

Paragrafi 10.01 Palët e interesuara.

Kjo Kontrate do të jetë detyruese dhe vetëm për të mirën e secilës Pale në këtë Kontrate, dhe asgjë në këtë Kontrate, e shprehur apo e nënkuptuar, nuk ka për qëllim të japë ose do të japë ndonjë Personi tjetër ndonjë të drejtë, përfitim, ose mjete ligjore të çdo natyre sipas kësaj Kontrate ose për shkak të saj.

Paragrafi 10.02 Cedimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasojë juridike ndaj Palëve, trashëgimtareve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është ceduar në mënyrë të rregullt.

Paragrafi 10.03 Pavlefshmëria e pjeshme

Nëse pjesë të kësaj Marrëveshjeje janë ose bëhen të pavlefshme ose jodetyruese, Palët do të jenë të detyruara të zbatojnë pjesën tjetër të Marrëveshjes. Palët përkatëse do të zëvendësojnë në këtë rast pjesën e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime të vlefshme e detyruese dhe fuqia e të cilave, sipas përmbajtjes



dhe qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje, është sa më shumë të jete e mundur e ngjashme me pjesën e pavlefshme ose jodetyruese.

Paragrafi 10.04 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga njëra Palë për të ushtruar një ose më shumë të drejta që i janë dhënë nga ose në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen si dorëheqje përfundimtare dhe e përhershme nga ushtrimi i këtyre të drejtave.

Paragrafi 10.05 Garanci të mëtejshme

Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje do të kryejë këto veprime të mëtejshme dhe do të nënshkruajë dokumente të tjera të nevojshme për të kryer e dhëne fuqi të plote parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje dhe qëllimeve të Palëve të pasqyruara në të.

Paragrafi 10.06 Monedha

Përveç rastit kur parashikohet ndryshe, çdo dhe të gjitha pagesat në lidhje me këtë Marrëveshje do të kryhen në monedhën Lekë.

Paragrafi 10.07 Negocimi i Marrëveshjes.

Secila Pale pranon se është përfaqësuar nga një këshilltar i pavarur i zgjedhur prej tij përgjatë gjithë negociatave që kanë paraprirë nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe se ka nënshkruar këtë Kontratë me miratimin dhe këshillimin e këshilltarit të pavarur të sipërpërmendur. Secila Pale dhe këshilltari i saj kanë bashkëpunuar në hartimin dhe përgatitjen e kësaj Kontrate dhe dokumentat e referuar këtu si dhe të gjithë draftet e lidhura me të, do të konsiderohen si produkt i punës së Palëve dhe nuk mund të interpretohen kundra asnjë Pale për shkak të përgatitjes së saj. Për këtë arsye, çdo rregullim ligjor apo ndonjë vendim ligjor që do të kërkonte interpretimin e ndonjë paqartësie në këtë Kontratë kundër Palës që e hartoi, nuk do të zbatohet dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate hiqet dore në mënyrë të shprehur nga kjo. Dispozitat e kësaj Kontrate do të interpretohen në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të bëjnë efektiv qëllimet e Palëve në këtë Kontratë.

Paragrafi 10.08 Gjuha

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe.

Paragrafi 10.09 Kopjet e njëjta

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje dhe çdonjëra prej të cilave kur është e nënshkruar dhe dorëzuar nga të dy Palët në mënyrë të rregullt, do të konsiderohet si origjinale dhe të gjitha së bashku do të përbëjnë një dokument të vetëm.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët nënshkruajnë Marrëveshjen rregullisht me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë.



PALËT

SHITËSI

Z.Andi Zhugli



BLERËSI

Z.Alfred Bundo



ALBENECON
Sh.p.k.
NUIS : L 82031006 T
TIRANE - ALBANIA

